

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

Nr. rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
1	07.04.2023	Me Erdhi dhe ky mesazh. Eshte drejtuar nga zyra juaj? Gjithashtu akoma nuk kam asnjë muaj pagese në llogari.	12.04.2023	Sa më sipër, duke vlerësuar shtetësimin tuaj Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë do të vijojë komunikimet me IAL-të me qëllim zgjidhjen e kësaj problematike.	Përgjigjia jepet e plotë	
2	12.04.2023	Kërkesë për informacion e deleguar nga MAS, në vijim të ankesës së administruar në platformën e bashkëveprimjes, në lidhje me ankesën e studentes së UMT, për mos marrjen e bursës së mbështetjes financiare.	13.04.2023	AKFAL me datë 13.04.2023 ka përcjellë ankesën pranë UMT, e cila ka kthyer përgjigje më datë 13.04.2023. Më datë 13.04.2023 AKFAL ka Kthyer përgjigje MAS si më poshtë. "Sipas informacionit të marrë nga administratorja e Universitetit të Mjekësisë Tiranë, znj. Sonila Shkjeri, rezultoni se mbështetja financiare nga ky universitet ka kaluar."	Përgjigjia jepet e plotë	
3	12.05.2023	Ankesa e studentes së Universitetit "Luigj Gurakuqi", Shkodër përfituese të mbështetjes studentore, e cila pretendon se ende nuk ka kaluar masa e mbështetjes financiare. Studentja ka kërkuar informacion se kur do të realizohet pagesa.	16.05.2023	Referuar ankesës me objekt "vonesën në kalimin e fondit për mbështetjen financiare, nga IAL", kjo e fundit është trajtuar në grup për të gjithë studentët. Ankesa është deleguar pranë Universitetit të Shodrës, në vijim fondi për mbështetjen financiare është akorduar nga IAL në llogaritë e studentëve dhe studentja është informuar.	Deleguar	
4	29.06.2023	Kërkesë për informacion mbi bursën e ekelesencës, nëse nuk është përfituar në vitin e parë të universitetit, por në vitin e dytë ka mesatare mbi 9.5 a mund ta përfitojë në vit të dytë.	30.06.2023	Në përgjigje të kërkesës tuaj, nëpërmjet së cilës kërkoni informacion në lidhje me mbështetjen financiare, ju bëjmë me dije se: Bazuar në VKM-në nr. 386 datë 01.06.2022, përfitues të mbështetjes financiare nga buxheti i shtetit ose të ardhura të tjera të ligjshme, për vitin akademik 2022-2023, e në vijim, janë studentët shtetas shqiptarë, të pranuar në institucionet publike të arsimit të lartë, që nuk janë njëkohësisht përfitues të ndonjë financimi tjetër nga shteti shqiptar dhe që plotësojnë kriteret. Pra mund të përfitojnë vetëm studentët të cilët regjistrohen në vitin e parë. Në këto kushte, përsa i përket rastit të referuar nga ana juaj, studenti nuk mund të përfitojë mbështetje financiare në kuptim të VKM-së nr. 386/2022, por mund të jetë përfitues sipas VKM-së nr. 903/2016, i ndryshuar.	Përgjigjia jepet e plotë	
5	03.07.2023	Ankesë e studentes përfituese e mbështetjes studentore, e cila parashtrohet se nuk na kanë kaluar deri tani 7 muaj me nga 340 mij duke na llogarituar edhe muajin prill 340 dhe jo 400 sa duhet.	06.07.2023	Në përgjigje të ankesës suaj, administruar në rrugë elektronike pranë Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë, ju bëjmë me dije se: AKFAL është dukë ndjekur ankesën tuaj, si dhe e ka përcjellë atë pranë Universitetit "Luigj Gurakuqi", Shkodër më datë 06.07.2023. Në përfundim ju do të informohen nga ana jonë në lidhje me trajtimin dhe përfundimet e arritura pas shtetësimin.	Deleguar	
6	08.07.2023	Kërkesë për informacion nëse muaji qershor është i përfshirë në marrjen e bursës për studentet e degeve prioritare, pasi në kontratë thuhet se është vlefshme aq sa vazhdon frekuencimi i institucionit dhe deges.	14.07.2023	Në vijim të kërkesës suaj për informacion në lidhje me periudhën e përfitimit të mbështetjes financiare për një vit akademik ju bëjmë me dije se: Referuar marrëveshjes trepalëshe, përfituesi financohet në nivelin e pagës minimale në shkallë vendi, për çdo muaj të frekuencimit të procesit mësimor të vitit akademik 2022-2023, si dhe të vitit akademik pasardhës, sipas kalendarit të vitit akademik për programin përkatës të studimit, por jo më shumë se 10 muaj kalendarik, pas konfirmimit të frekuencimit të programit përkatës të studimit nga institucioni publik i arsimit të lartë, ku është regjistruar përfituesi. Në lidhje me kohëzgjatjen e procesit mësimor, për çdo program studimi miratohet plani mësimor nga Fakulteti përkatës i çdo IAL-je. Sa më sipër, ju mund të drejtoheni pranë Fakultetit në të cilin ndiqni studimet me qëllim informimin për çështjen e parashtuar nga ana juaj. Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,	Përgjigjia jepet e plotë	